

**VENDIM I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË AKSIONERËVE
(AKSIONERIT TË VETËM)**

"KASTRATI GROUP" sh.a

është një shoqëri anonime shqiptare, themeluar në datë 30/04/2002
regjistruar në mënyrë të rregullt në Qendrën Kombëtare të Biznesit ("QKB"), me numër
unik identifikimi të subjektit : NUIS K21711502V, ("Shoqëria").

Vendi i mbledhjes : Mbledhja është thirrur në selinë e shoqërisë "KASTRATI GROUP"
sh.a me adresë : Lagja 14, Rruga "Tiranës" , ura e "Dajlanit" Durrës, Shqipëri.

Data e mbledhjes : 06.09.2022

Nr. i vendimit : 21

Prezent në mbledhje është aksioneri i vetëm i shoqërisë z.Shefqet Kastrati.

Asambleja është thirrur rregullisht dhe është e aftë të marrë vendime të vlefshme lidhur
me rendin e ditës si më poshtë vijon :

Rendi i ditës :

1. Fillimi i procedurave për zvogëlimin e kapitalit të shoqërisë nga vlera aktuale
2,500,000,000 lekë në 140,850,000 lekë.
2. Miratimin e Audituesit Ligjor për të përgatitur raportin për zvogëlimin e kapitalit.
3. Të ndryshme.

DUKE QËNË SE :

Kastrati Group sh.a është një shoqëri anonime shqiptare, themeluar në datë 30/04/2002,
regjistruar në mënyrë të rregullt në Qendrën Kombëtare të Biznesit ("QKB"), me numër
unik identifikimi të subjektit (NUIS) K21711502V, ("Shoqëria ")

Para fillimit të zvogëlimit të kapitalit shoqëria ka një kapital të regjistruar në QKB prej
2,500,000,000 lekë i ndarë në 2.500.000 aksione me vlerë 1.000 lekë për aksion.

Aksioneri i vetëm i shoqërisë z.Shefqet Kastrati për interes të strategjive të zhvillimit të
biznesit kërkon që të zvogëloj kapitalin themeltar të shoqërisë i cili nga 2,500,000,000
lekë zvogëlohet me shumën 2,359,150,000 lekë dhe mbetet në shumën 140,850,000 lekë.

Vlera e kapitalit të shoqërisë që do të zvogëlohet nuk do të shpërndalet për aksionerin e
vetëm por do të mbetet pjesë e kapitaleve neto të shoqërisë.



Të gjitha kërkesat për mbajtjen e një mbledhje të rregullt janë përmbushur në përputhje me statutin e shoqërisë dhe Ligjin Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregëtare.

Ky zvogëlim bëhet në funksion të interesave strategjike të zhvillimit të shoqërisë dhe nuk ka asnjë ndikim në vlerën e aktiveve neto të shoqërisë.

PËR SA MË SIPËR, aksioneri i vetëm i shoqërisë "Kastrati Group" sh.a

VENDOSI :

1. **Të miratojë** fillimin e procedurës për zvogëlimin e kapitalit të shoqërisë në vlerë totale 2,359,150,000 lekë (dy miliard e treqind e pesëdhjetë e nëntë milion e njëqind e pesëdhjetë mijë lekë).
Kapitali i shoqërisë nga 2.500.000,000 lekë mbas zvogëlimit bëhet 140,850,000 lekë.
2. **Të miratojë** emërimin në cilësinë e Audituesit Ligjor për hartimin e raportit përkatës për zvogëlimin e kapitalit si më sipër, shoqërinë "MAZARS" sh.p.k shoqëri audituese.
3. Të ngarkojë administratorin e shoqërisë z.Gani KASTRATI të bëjë depozitimin e të gjithë akteve të zvogëlimit të kapitalit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, Tiranë.

Asnjë vendim tjetër nuk është marrë në këtë mbledhje të përgjithshme të Asamblesë së Aksionerëve të shoqërisë.

Aksioneri i vetëm i shoqërisë
"KASTRATI GROUP "sh.a

Shefqet KASTRATI



**VENDIM I ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME TË AKSIONERËVE
(AKSIONERIT TË VETËM)**

"KASTRATI GROUP" sh.a

është një shoqëri anonime shqiptare, themeluar në datë 30/04/2002
regjistruar në mënyrë të rregullt në Qendrën Kombëtare të Biznesit ("QKB"), me numër
unik identifikimi të subjektit NUIS K21711502V, ("Shoqëria").

Vendi i mbledhjes : Mbledhja është thirrur në selinë e shoqërisë "KASTRATI GROUP"
sh.a me adresë : Lagja 14, Rruga "Tiranës" , ura e "Dajlanit" Durrës, Shqipëri.

Data e mbledhjes : 19.09.2022

Nr. i vendimit : 22

Prezent në mbledhje është aksioneri i vetëm i shoqërisë z. Shefqet Kastrati.

Asambleja është thirrur rregullisht dhe është e aftë të marrë vendime të vlefshme lidhur
me rendin e ditës si më poshtë vijon:

Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i zvogëlimit të kapitalit të shoqërisë me vlerën 2,359,150,000
lekë (dy miliardë e treqind e pesëdhjetë e nëntë milion e njëqind e pesëdhjetë mijë
lekë) lekë. Kapitali i shoqërisë nga 2.500.000,000 lekë mbas zvogëlimit bëhet
140,850,000 lekë.
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të Audituesit Ligjor për zvogëlimin e kapitalit të
shoqërisë;
3. Të tjera.

Pas diskutimit të çështjeve duke qenë se të gjitha kërkesat për mbajtjen e një mbledhje të
rregullt janë përmbushur në përputhje me statutin e shoqërisë dhe Ligjin Për Tregtarët
dhe Shoqëritë Tregtare, aksioneri i vetëm i shoqërisë "KASTRATI GROUP" sh.a

VENDOSI

1. Të miratojë zvogëlimin e kapitalit të shoqërisë " Kastrati Group " sh.a në vlerën
2,359,150,000 lekë (dy miliardë e treqind e pesëdhjetë e nëntë milion e njëqind e
pesëdhjetë mijë lekë) lekë.



Kapitali i shoqërisë nga 2.500.000,000 lekë mbas zvogëlimit bëhet 140,850,000 lekë.

Vlera prej 2,359,150,000 lekë me të cilën zvogëlohet kapitali i shoqërisë do të kalojë si pjesë e kapitaleve të veta dhe nuk do të shpërndalet për aksionerin e vetëm të saj.

Zvogëlimi i kapitalit do të bëhet duke ulur numrin e aksioneve të shoqërisë.

- Numri aktual i aksioneve është 2.500.000 aksione.
- Numri i aksioneve që do të ulet është 2,359,150 aksione dhe
- Numri i aksioneve që mbeten pas zvogëlimit është 140.850 aksione.

Vlerë nominale e aksioneve mbetet e pa ndryshuar 1.000 lekë/aksion.

Kapitali themeltar i shoqërisë nga 2,500,000,000 lekë (dy miliard e pesëqind milion) zvogëlohet me shumën 2,359,150,000 lekë (dy miliardë e treqind e pesëdhjetë e nëntë milion e njëqindëe pesëdhjetë mijë lekë) dhe bëhet 140,850,000 lekë (njëqind e dyzet milion e tetëqind e pesëdhjetë mijë) .

Numri i aksioneve nga 2.500.000 aksione do të ulet me 2,359,150 aksione dhe mbeten 140,850 aksione. Vlera nominale mbetet 1,000 lekë/aksion.

Aksioneri i vetëm i shoqërisë është z. Shefqet KASTRATI i cili zotëron 100% të kapitalit të shoqërisë.

2. Të miratojë Raportin e Audituesit Ligjor MAZARS sh.p.k përgatitur për zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë " KASTRATI GROUP " sh.a.
3. Të ngarkojë administratorin e shoqërisë z.Gani KASTRATI të bëjë depozitimin e të gjithë akteve të zvogëlimit të kapitalit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit Tiranë.

Asnjë vendim tjetër nuk është marrë në këtë mbledhje të përgjithshme të Asamblesë së Aksionerëve të shoqërisë. Për sa u diskutua në mbledhje, u mbajt ky proces verbal, i cili nënshkruhet nga aksioneri i vetëm pasi ai u lexua me zë të lartë.



Aksioneri i vetëm i shoqërisë
KASTRATI GROUP "sh.a

z. Shefqet KASTRATI

“KASTRATI GROUP” SH.A

RAPORTI I DHËNIES SË SIGURISË I AUDITUESIT LIGJOR

**MBI VERIFIKIMIN E PASQYRËS SË KAPITALEVE TË VETA NË 31.12.2021
PËR QËLLIM TË ZVOGËLIMIT TË KAPITALIT THEMELTAR TË SHOQËRISË
SIPAS VENDIMIT TË ASAMBLESË SË AKSIONERËVE (AKSIONERIT TË VETËM)
NR.21, DATË 06/09/2022**

mazars



Emin Duraku Str. Binjaket Build.
No.5, 1009, Tirana
Albania
Tel: +355 4 2222 889
www.mazars.al

RAPORT I DHËNIES SË SIGURISË I AUDITUESIT LIGJOR
Drejtuar: AKSIONERIT TË VETËM TË SHOQËRISË
“ KASTRATI GROUP ” sh.a

Qëllimi i angazhimit :

Asambleja e Aksionerëve (Aksioneri i vetëm) i shoqërisë me vendimin nr. 21 datë 6 Shtator 2022, na ka angazhuar si auditues ligjor për të verifikuar dhe për të dhënë siguri të arsyeshme në lidhje me saktësinë e seksionit të kapitaleve të veta, të pasqyrave financiare të shoqërisë deri në vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2021, për qëllim zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë " Kastrati GROUP " sh.a.

Kriteret

Për të përmbushur këtë angazhim ne jemi bazuar në:

- Kapitalin e regjistruar të shoqërisë " Kastrati GROUP " sh.a dhe strukturën e aksioneve në përputhje me të dhënat e shoqërisë sipas "Ekstraktit të Regjistrimit Tregtar" për të dhënat e subjektit të Qendrës Kombëtare të Biznesit më datë 13 Shtator 2022.
- Vendimin e Asamblesë së Aksionerëve (Aksionerit të vetëm) nr.21 datë 6 Shtator 2022 (bashkëngjitur këtij Raporti).
- Pasqyrat financiare të shoqërisë për periudhën deri në 31.12.2021.
- Standardet Kombëtare të Kontabilitetit, Ligji Nr.25 datë 10.05.2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare",
- Ligji Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

Përgjegjësia e drejtimit

Drejtimi i shoqërisë është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të të gjitha pasqyrave për qëllim të zvogëlimit të kapitalit (në vijim pasqyrat financiare), përgatitjen e akteve juridike dhe të zbatimit të procedurave ligjore e staturore të nevojshme për zvogëlimin e kapitalit në përputhje me kriteret e sipërpërmendura.

Kjo përgjegjësi përfshin: përcaktimin, ushtrimin dhe mbajtjen e kontrollit të brendshëm të përshtatshëm për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare të cilat nuk përmbajnë keqdeklarime materiale, qoftë si rezultat i mashtrimeve apo gabimeve; zgjedhjen dhe zbatimin e parimeve të duhura kontabël; dhe kryerjen e çmuarjeve kontabël të arsyeshme për rrethanat financiare.

Drejtimi është përgjegjës për respektimin e të drejtave të aksionerit të vetëm dhe kryerjen e llogaritjes së drejtë të pasqyrës së zvogëlimit të kapitalit, numrit të aksioneve dhe vlerës së tyre, në momentin e zvogëlimit të kapitalit dhe për respektimin e modaliteteve ligjore dhe staturore për thirrjen e asamblesë me rend dite zvogëlimin e kapitalit themeltar.

mazars

Përgjegjësia jonë

Përgjegjësia jonë është që, bazuar në procedurat e kryera, të shprehim një opinion në se shifrat e kapitalit, rezervave dhe fitimeve dhe humbjeve janë të pasqyruara saktë në kontabilitet dhe nëse këto shuma përputhen me të dhënat e pasqyrave financiare dhe shuma e përcaktuar nga aksioneri i vetëm për zvogëlimin e kapitalit është e saktë dhe përputhet me kontabilitetin dhe me të dhënat e ekstraktit të Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Ne e kryem auditimin në pajtim me **Standartet Ndërkombëtare të Angazhimeve të Dhënies së Sigurisë (SNAS 3000) “ Angazhime të dhënies së Sigurisë që ndryshojnë nga auditimet apo rishikimet e informacioneve financiare historike ”** dhe standartet e tjera që lidhen me çështjen në fjalë. Këto standarde kërkojnë që ne të planifikojmë dhe të kryejmë procedurat e nevojshme për të dhënë një nivel sigurie të arsyeshëm që informacionet e përgatitura nga drejtimi i shoqërisë janë të vërteta dhe të sinqerta në të gjitha aspektet materiale dhe në aspektin e tyre matematikor, kjo për qëllim të zvogëlimin të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Procedurat e kryera nga ana jonë për këtë angazhim përfshijnë:

Bazuar në dokumentacionin që na është vënë në dispozicion nga drejtimi i shoqërisë “KASTRATI GROUP” sh.a procedurat e kryera nga ana jonë përfshijnë:

1. Verifikimin e seksionit të “Kapitaleve të veta” të shoqërisë dhe përputhshmërinë e tyre me ato të paraqitura në pasqyrat financiare të vitit ushtrimor të mbyllur më 31 Dhjetor 2021.
2. Verifikimin e “Pasqyrës së kapitaleve të veta para dhe mbas zvogëlimin të kapitalit” përgatitur nga administratori i shoqërisë më datë 6 Shtator 2022 me qëllim zvogëlimin e kapitalit.
3. Verifikimin e llogaritjeve për numrin e uljes së aksioneve dhe vleres si efekt i zvogëlimin të kapitalit Aksionar, sipas kërkesave të përcaktuara në vendimin e aksionerit të vetëm të shoqërisë nr. 21 datë 6 Shtator 2022.

Konkluzioni:

1. Bazuar në procedurat e kryera, shuma e kapitaleve të veta sipas pasqyrave financiare të mbyllura më 31.12.2021 janë si më poshtë:

	<u>31.12.2021</u>
Kapitali i nënshkruar	2,500,000,000
Rezerva ligjore	506,066,818
Rezerva të tjera	7,385,474,630
Rezultati i vitit ushtrimor	4,871,716,325
Shuma e Kapitaleve të veta	<u>15,263,257,773</u>

Këto shuma rakordojnë me llogaritë përkatëse dhe dokumentacionin mbështetës që ne verifikuam. Pasqyra Financiare e kapitaleve të veta si dhe shënimet e lidhura me to, për qëllim të zvogëlimit të kapitalit Aksionar të shoqërisë, jep një pasqyrim të sinqertë dhe të vërtetë të gjendjeve të "Kapitaleve të veta" për ushtrimin e mbyllur më 31 Dhjetor 2021.

2. Vlerat e kapitalit të nënshkruar, rezervave, fitimeve të vitit ushtrimor të detajuara në "Pasqyrën e kapitaleve të veta para dhe mbas zvogëlimit të kapitalit" janë të pasqyruara me vërtetësi. Vlera prej 2,359,150,000 Lek që do të zvogëlohet kapitali i nënshkruar që është pasqyruar në pasqyrat financiare të shoqërisë mbas zvogëlimit nuk do të kalojë për shpërndarje por do të mbetet pjesë e kapitaleve të veta dhe kapitalet e veta para zvogëlimit të kapitalit dhe mbas zvogëlimit nuk ndryshon. Vlera e kapitaleve të veta është në shumën 15,263,257,773 Lek si para dhe mbas zvogëlimit të kapitalit si në tabelën në vijim:

Kapitalet e veta 31.12.2021	Vlera e kapitaleve të veta para zvogëlimit	Shuma e kapitalit që do të zvogëlohet	Vlera e kapitaleve të veta mbas zvogëlimit
Kapitali i nënshkruar	2,500,000,000	(2,359,150,000)	140,850,000
Rezerva statutore	-	-	-
Rezerva ligjore	506,066,818	-	506,066,818
Rezerva të tjera	7,385,474,630	2,359,150,000	9,744,624,630
Fitime të pashpërndara	-	-	-
Rezultati neto i vitit 2021	4,871,716,325	-	4,871,716,325
Totali i kapitaleve të veta	15,263,257,773	-	15,263,257,773

3. Shuma e kapitalit që do të zvogëlohet prej 2,359,150,000 Lek, e përcaktuar në vendimin nr. 21, datë 06/09/2022 për zvogëlimin e kapitalit themeltar, është në përputhje me shumën e kapitalit themeltar të pasqyruara në pasqyrat e saj financiare në 31.12.2021 si edhe të ekstraktit të Qendrës Kombëtare të Biznesit datë 13 Shtator 2022. Shuma e zvogëluar pasqyron me vërtetësi raportin e këmbimit të kapitalit në rezerva të tjera të shoqërisë.

mazars

Mbas miratimit të zvogëlimit të kapitalit të nënshkruar nga aksioneri i vetëm, kapitali i shoqërisë "KASTRATI GROUP" sh.a bëhet si më poshtë:

- Kapitali themeltar i shoqërisë "KASTRATI GROUP" sh.a ishte 2,500,000,000 Lek, zvogëlohet me 2,359,150,000 Lek dhe bëhet 140,850,000 Lek.
- Zvogëlimi do të bëhet duke anuluar 2,359,150 aksione me vlerë nominale 1,000 Lek/aksion dhe numri i aksioneve mbas zvogëlimit të kapitalit do të bëhet 140,850 aksione me vlerë nominale 1,000 Lek /aksion;
- Zotërues 100% i kapitalit të shoqërisë është aksioneri i vetëm i saj z.Shefqet Kastrati.

Me respekt

mazars
Ernin Duraku Str., Binjaket Build.,
No.5, 1013 Tirana, Albania
NUS: 132123006W

Teit Gjini
Auditues Ligjor

Tiranë më 14 Shtator 2022